



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 53 dhe 54 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 12 i Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Dragashit 01.nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, pas propozimit të kryetarit të Komunës së Dragash-it, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 31.10.2023 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMEVE 01 Nr.941/01-24752-5/23 I DATËS 15.09.2023 PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE VENDIMI 01 Nr.941/01-24752-6/23 I DATËS 15.09.2023 PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS.

- I. **APROVOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës së Dragash-it i cili ka për qëllim anulimin e Vendimit 01 Nr.941/01-24752-5/23 të datës 15.09.2023, për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për komunën e Dragashit dhe Vendimit 01 Nr.941/01-24752-6/23 i datës 15.09.2023, për iniciimin e procedurës për hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK-së) për komunën e Dragashit.
 - II. Pas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me nr. të protokollit 5549-2/23 të datës 04.10.2023, për rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.941/01-24752-5/23 të datës 15.09.2023, për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me nr. të protokollit 5548-2/23 të datës 04.10.2023, për rishqyrtimin e vendimit 01 Nr.941/01-24752-6/23 të datës 15.09.2023, për Iniciimi e procedurës për hartimin e hartës Zonale të Komunës, për shkak se Ligji për Ndërtim dhe Ligji për Planifikim Hapësinor është në komisionet Parlamentare dhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe së shpejti pritet të miratohet dhe sipas draftit të këtyre ligjeve parashihen që këto dokumente (Plani Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale) të bëhen në një dokument.
 - III. Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës.
 - IV. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragash-it.
- I dërgohet:**
- Kryetarit të Komunës së Dragash-it z.Bexhet Xheladini,
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) – Prishtinë dhe
 - Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS DRAGASH

01 Nr. 060/01-29527-1/23

Dt. 31.10.2023



Kryesuesi i Kuvendit:

Uran Halimi